

Adresimi i çështjeve që lidhen me brezin e ri është thelbësore sa për shoqëritë që rriten aq dhe për sigurimin e shtyllave të zhvillimit të një shoqërie. Ekspozimi i talenteve dhe aftësive të të rinjve ka një ndikim të madh në rritjen e vetëdijes qytetare mbi aftësimin profesional dhe krijimin e “aseteve” njerëzore në tregun e punës.

Kjo ishte motoja që frymëzoi shoqatën **“Gruaja në INTEGRIM”** Shkodër për të konceptuar sëbashku me të rinjtë e shkollës së mesme Pyjore iniciativën me titull: **“E drejta e punës përmes shprehisë së veprimit”**.



Nxitja e të rinjve drejt marrjes së një profesioni është vlerësuar si mekanizëm aftësimi dhe punësimi për të rinjtë e rajonit të veriut në përgjithësi e ato të “Shkollës së Mesme Pyjore” në veçanti. Shkollat e mesme me orientim profesional janë institucione ku nxënësit arsimohen dhe pajisen me kompetenca profesionale. E ardhmja e arsimit profesional si mekanizëm në tregun e punës është vlerësuar dhe orientuar si politikë punësimi dhe sipërmarrjeje vitet e fundit.



Promovimi i aftësive të spikatura dhe nxitja e sipërmarrjes profesionale janë dy kolonat e konceptimit të kësaj iniciative e cila u mbështet nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë përmes iniciativës **“Youth Standing Up for Human Rights in Albania”** zbatuar nga World Vision Albania

Zbatimi i kësaj iniciative ka si qëllim nxitjen dhe mbështetjen e të rinjve me arsim profesional drejt sipërmarrjeve të qëndrueshme.

Objektivat specifike të kësaj iniciative janë:

1. **Promovimi i të rinjve që ndjekin arsimin profesional;**
2. **Aftësimi i të rinjve për t'i dhënë jetë profesionit.**
3. **Integrimi i të rinjve me aftësi ndryshe;**

Përmes kësaj iniciative të rinjtë e Shkollës së Mesme Pyjore do të angazhohen në zbatimin e veprimtarive të cilat do të stimulojnë shprehitë e veprimit dhe të punës në zanat! Aktivitetet e planifikuara i shërbejnë përmbushjes së objektivave dhe arritjeve të pritshme të kësaj iniciative.

Veprimtari të planifikuara në përputhje me aftësitë e të rinjve target:

1. **PREZANTIMI I INICIATIVES SË TË RINJVE NË RAJON PËR TË GJITHA GRUPET E INTEREST**
2. **NGRITJA E GRUPEVE TË PUNËS NË SHKOLLA**
3. **ORGANIZIMI I “DITËVE TË SHËRBIMIT KOMUNITAR”**
4. **VIZITA STUDIMORE NË SIPËRMARRJE PRIVATE – SEKTORI I PËRPUNIMIT TË DRURIT DHE MOBILERISË.**
5. **TRAJNIM I TË RINJËVE ME “BAZAT E SIPËRMARRJES”**
6. **PANAIRI I PUNES ME DRU NGA TË RINJTË E SHKOLLËS PYJORE**



Kjo iniciativë pritet të ketë impakt pozitiv përmes rezultateve si më poshtë:

- ✓ Të rinjtë e shkollës së mesme pyjore marrin njohuri mbi "Bazat e sipërmarrjes" dhe praktikave të mira në fushën e mobilierisë;
- ✓ Të rinjtë target njohin kriteret dhe procedurat e ngritjes së një sipërmarrje;
- ✓ Marrëveshje Mirëkuptimi (MoU) me bizneset e përpunimit të drurit për pranimin e të rinjve në praktika mësimore.
- ✓ Praktikant më të mira të sipërmarrjes private në nivel rajonal janë njohur dhe modelet e sipërmarrjeve të suksesshme janë të replikueshme.
- ✓ "Panairi i Punës në Dru" ekspozon aftësitë profesionale të të rinjve të shkollës së mesme pyjore "Kol Margjini";
- ✓ Grupet në nevojë të përkujdesjes si shtëpia e të moshuarve dhe shkolla speciale "3 Dhjetori" janë përfitues të "DITËVE TË SHËRBIMIT KOMUNITAR"
- ✓ Iniciativa i jep akses fëmijëve me aftësi të kufizuara për t'u ndjerë të përfshirë në nisma të përbashkëta;



INICIATIVA:

“E DREJTA E PUNËS PËRMES SHPREHISË SË VEPRIMIT”

“Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyron detyrimisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

